



Rrjeti i Organizatave të Grave Romë, Ashkali dhe Egjiptase të Kosovës  
The Network of Roma, Ashkali & Egyptian Women Organizations of Kosovo  
E Kosovës Romane, Ashkalenjë dhe Egjiptasë Qjwëngro Organizaciengji Kedin



Qendra Kosovare për Studime Gjinore  
Kosovar Center for Gender Studies

---

# **Pozita e Grave të Komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptas në Kosovë**

**Tetor, 2008**

## **Historia e RROGRAEK-ut**

Rrjeti i Organizatave të Grave Rome, Ashkali dhe Egjiptase të Kosovës është themeluar në fillim të vitit 2000 si rrjet joformal i organizatave dhe aktivisteve nga të gjitha viset e Kosovës.

Me gjithë dëshirën dhe vullnetin e anëtareve të rrjetit për të vazhduar aktivitetet, rrjeti pati ndërprerje të punës dhe aktiviteteve për një periudhë kohore.

Në Dhjetor të vitit 2006, me përkrahjen e UNIFEM-it, zyra në Kosovë në bashkëpunim dhe mbikëqyrje të Luljeta Vuniqit nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore në Prishtinë dhe në bashkëpunim me Shpresa Agushin përfaqësuese e organizatës së Grave Rome “Romane Romnja” në Gjilan, rrjeti rifilloi punën si organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse me strategji të qartë veprimi. Për rikëmbjen e rrjetit ndihmuan edhe aktivistet dhe përfaqësueset e organizatave duke marrë pjesë nëpër takime që të qartësohen objektivat dhe përpilimin e strategjisë.

Tani rrjeti përbëhet prej 25 anëtareve (organizata dhe gra aktiviste). Fushat në të cilat janë të fokusuara këto organizata janë: Arsimi, Integrimi – Riintegrimi, Shëndetësia dhe të Drejtat e Grave të Komunitetit Rome, Ashkali dhe Egjiptase.

Rrjeti përbëhet edhe nga një bord shtatë anëtarësh. Anëtarë të cilët janë aktivistë, ekspertë për çështjet e të drejtave të komuniteteve dhe të drejtave të grave.

Qëllimi i RROGRAEK-ut është që të përkrahë, të mbrojë dhe të promovojë të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave nga komuniteti Rome, Ashkali dhe Egjiptase në gjithë Kosovën, pavarësisht nga përkatësia e tyre politike, fetare, etnike, mosha, niveli i arsimit, orientimi seksual dhe aftësia. RROGRAEK-u e realizon këtë qëllim përmes shkëmbimit të përvojës dhe informatave, partneritetit, rrjetëzimit, hulumtimeve, avokimit dhe shërbimeve.

### **Objektivat e RROGRAEK janë:**

1. Të sigurojë pjesëmarrjen e barabartë, aktive dhe efektive të grave dhe të vajzave Rome, Ashkali dhe Egjiptase në zhvillimet politike, ekonomike dhe shoqërore në Kosovë;
2. Të avokojë për të drejtat e grave dhe vajzave Rome, Ashkali dhe Egjiptase në të gjitha sferat e jetës;
3. Të fuqizojë lëvizjen e grave dhe vajzave Rome, Ashkali dhe Egjiptase në parandalimin e martesave të hershme dhe ngritjen e nivelit të edukimit shëndetësor;
4. Të realizojë përfshirjen e grupeve të grave të Kosovës në iniciativa rajonale dhe ndërkombëtare në fushën e

promovimit të të drejtave të grave dhe vajzave;

5. Të avokojë për përfshirjen e grave dhe vajzave Rome, Ashkali dhe Egjiptase në të gjitha nivelet e arsimit;

**Misioni i RROGRAEK-ut është përkrahja, integrimi dhe promovimi i të drejtave të grave dhe vajzave të komuniteteve Rome, Ashkali dhe Egjiptase në Kosovë.**



**RROGRAEK-u në bashkëpunim me QKSGJ-në ka arritur të bëjë:**



1. Anëtarësimin e OJQ të grave dhe vajzave aktiviste në RROGRAEK
2. Në bashkëpunim me anëtarët e rrjetit dhe QKSGJ-në, rrjeti ka arritur të bëjë regjistrimin formal në shtator të vitit 2007.
3. Të formojë Bordin Ekzekutiv dhe të zgjedhë kryetaren e Bordit.
4. Të zgjedhë menaxhmentin e rrjetit
5. Rrjetit ka mbajtur mbledhje me donatorë ku qëllimi ishte që anëtarët e rrjetit të njoftohen me donatorët, me programet e tyre, projektet që i kanë realizuar, projektet që janë në realizimin e sipërm.
6. Të realizojë hulumtimi “Braktisja e vajzave të reja nga shkolla” (Hulumtimi është realizuar me mostër të vogël dhe qëllimi i këtij hulumtimi ka qenë që koordinatore të Rrjetit të mësohen dhe trajnohen për teren. Qendra Kosovare për Studime Gjinore ka mbajtur me koordinatore të Rrjetit këto trajnime: Hulumtimet sociale: Praktikën, rolin dhe rëndësia të tyre; Hulumtimi Kuantitativ: Llojet dhe Metodën; Hulumtimet Kualitative: Llojet dhe Metodën. Të dhënat e këtij hulumtimi janë përdorur si pikë orientuese për projektin në vazhdimësi).
7. RROGRAEK-u në bashkëpunim me QKSGJ-në, anëtarët e saj, organizatat ndërkombëtare në Kosovë dhe institucionet qeveritare të Kosovës në vitin 2007 ka përpiluar Planin Strategjikë 2008-2010. Ky plan ka për qëllim për të vazhduar punën në të ardhmen në mënyrë që të jetë një rrjet funksional në Kosovë që do të avokojë për nevojat dhe çështjet e grave që janë tejet të rëndësishme për gratë e këtyre komuniteteve.




8. Rrjeti me qëllimin të ngritjes së kapaciteteve të anëtareve të saja ka realizuar trajnime të ndryshme të mbajtura nga ATRC-ja siç janë:
  - a) Dizajni i Projekt Propozimeve
  - b) Hyrje në Avokim dhe Ndërtim të Koalicioneve
  - c) Qeverisja e mirë
  - d) Roli i OJQ-ve në Shoqërinë Civile
  - e) Monitorimi dhe evaluimi & Menaxhimi i Ciklit të Projektit
  - f) Menaxhmenti Bazik Financiar
9. Rrjetit gjithashtu ka mbajtur mbledhje të rregullta me anëtarët e rrjetit si dhe me anëtarët e bordit.
10. Rrjeti ka krijuar logon e RROGRAEK-ut, web – faqen dhe broshurën informuese.
11. Janë mbajtur për disa muaj rresht edhe kurse të kompjuterit dhe gjuhës angleze për ngritje të kapaciteteve të stafit të rrjetit
12. Me ndihmën e stafit të Qendrës Kosovare për Studime Gjinore, Stafi i Rrjetit ka përpiluar edhe udhëzuesin e politikave për punonjësit e rrjetit. (Ky material përmban në detale përgjegjësit dhe rregullat për punonjësit e rrjetit)
13. Qendra Kosovare për Studime Gjinore në bashkëpunim të ngushtë me Rrjetin ka realizuar hulumtimin “Pozita e grave dhe vajzave të komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptas në shoqërinë kosovare”; .
14. Që nga qershor 2008 koordinatore të Rrjetit janë trajnuar për administratë, financa, mirëmbajtje të web faqës, përpilim të raporteve, shkrim të projekteve ideore nga Stafi i Qendrës Kosovare për Studime Gjinore.
15. Në radhën e aktiviteteve të RROGRAEK-ut në bashkëpunim me QKSGJ-në organizojë dy vizita studimore në Maqedoni dhe Budapest me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe informatave rreth përvojës së punës së OJQ-ve të grave Rome në Maqedoni dhe organizatave në Budapest të cilat merren me programin e grave Rome në fusha të ndryshme. Organizimi i vizitës u ndihmua në mënyrë vullnetare nga stafi i organizatës së CRS në Maqedoni dhe nga stafi i ERRC dhe RPP në Budapest. Organizatat që u vizituan janë: RCS (Qendra Rome në Shkup) nga Znj. Azbija Memedova, Enisa Eminova nga projekti “Virgjiniteti”, organizata “Luludi” në Shkup, Organizata “Esma” në Shkup, organizata Kham në

Kumanovë, organizata “Daja” në Kumanovë, Institutit Për Shoqëri të Hapur në programin e pjesëmarrësve së Romëve dhe të Drejtat e Njeriut së bashku me Programin e Qeverisë në nivel lokal dhe qendror, Budapest, Programi Romë i Shëndetësisë në OSI, Budapest. Qendrën Evropiane për të Drejtat e Romëve, Budapest Fondin Edukativ për Romë, Budapest, Zyrën e Iniciativës Rome (RPP), Budapest etj.



16. Qendra Kosovare për Studime Gjinore në Kosovë dhe Rrjetit i Organizatave të Grave Rome, Ashkali dhe Egjiptiane të Kosovës, në mbështetjen nga UNIFEM, zyra në Prishtinë, organizoi një konferencë një-ditore rajonale mbi temën "Integrimi i grave të komunitetit Rome, Ashkali dhe Egjiptian". Qëllimi i konferencës ishte që të mundësojë integrimin e Romëve, Ashkali dhe Egjiptianëve të Rrjetit të Grave në rrjetet rajonale dhe iniciativat që adresojnë çështje të ngjashme dhe për të shkëmbyer përvoja.
17. Qendra së bashku me Rrjetin në qershor të vitit 2009 lansoi fushatën avokuese me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit të shoqërisë kosovare në lidhje me pozitën e grave Rome, Ashkali dhe Egjiptiane me fokus në arsim, një nga çështjet më të mëdha të Komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptas në Kosovë dhe në arsimin e grave që doli nga hulumtimi. Për realizimin sa më të suksesshëm të fushatës u realizua një spot televiziv që mbante mesazhin për përkrahjen e vajzave për shkollim.
18. Qendra në bashkëpunim me Rrjetin përgatiti Buletini informues për Aktivitetet e rrjetit. Ky buletini është shpërndarë tek të gjitha institucionet relevante.
19. Në vitin 2009. RROGRAEK-u hyri në partneritet me këto tri organizata siq janë: Unioni Ballkanik i Egjiptjaneve në Maqedoni, Save the Children dhe Forum SYD në Kosovë. Kurse nga viti 2006 RROGRAEK-u është në partneritet me QKSGJ-në dhe UNIFEM-i zyren në Kosovë dhe deri më tani kanë punuar në dy projekte një vjeçare dhe nga muaji Maj në projektin gjashtëmuor.







































Problemi i cili më së shumti u rëndon juve personalisht, ose familjen tuaj? - Zgjedhja 2







Problemi i cili më së shumti u rëndon juve personalisht, ose familjen tuaj? - Zgjedhja 3
























**"Është e natyrshe që pjesa më e madhe e punëve të shtëpisë të jenë detyrë e gruas"**



**"Nuk ka asgjë të keqe nëse një çift jeton së bashku pa dashur të martohet"**

